

FJALA E DEPUTETIT NIKO PELESHI

E ENJTE 20 TETOR 2022

Nuk kisha ndër mend të flisja, por ndërkohë që dëgjoja po mendoja se çfarë kontrasti ka ndërmjet diskutimeve që bëhen për sulmin kibernetik ndaj Shqipërisë në parlamentet e tjera, në samitet e NATO-s, në ministeriale, në Bruksel, ku kërkohet aleancë, kërkohet solidaritet dhe mbështetje për Shqipërinë. Por në këtë luftë të re, e kam thënë edhe herë tjetër dhe këtu në parlamentin shqiptar, ne nuk arrijmë dot të bëhemi një mendje dhe të bashkohemi kundër një sulmi aspak të thjeshtë, aspak të rastësishëm, të motivuar politikisht për shkak të angazhimeve që Shqipëria, jo Partia Socialiste apo qeveria saj, ka ndaj aleatëve ndërkombëtarë. Për shkak të tyre ne jemi goditur politikisht nga një fuqi, që, për fat të keq, është ndër më të sofistikuarat, edhe më të aftat në botë, nga Irani. Ky është një sulm i orkestruar nga Irani, që ka pikërisht këtë qëllim, të futë sherrin mes nesh, të krijojë trazira politike, të krijojë destabilitet, të na vërë kundër njëri-tjetrit dhe të arrijë ta gjunjëzojë Shqipërinë për arsye politike, për arsye që nuk kanë lidhje me politikën tonë të ditës, por kanë lidhje me angazhimet ndërkombëtare. Të bësh këtu pikërisht atë lojë, është hera e dytë që po përsërit të njëjtat fjalë, të bësh pikërisht atë që kërkon të arrijë kjo fuqi, Irani, do të thotë papërgjegjshmëri politike.

Edhe diçka tjetër desha të them. Ju këtu akuzoni pa kufi dhe duket sikur keni një epërsi në ato që thoni. Natyrisht, jeni në opozitë dhe opozita e ka epërsinë e të kërkuarit llogari dhe qeveria është gjithmonë në pozitën që duhet të japë llogari, por nuk mund të abuzoni me qytetarinë ose mungesën e qytetarisë. Unë nuk do ta bëja dot edhe po të kisha përballë, Flamur, dhe të thosha ato që ti nxjerr nga goja, emra, akuza, shifra, epitete. Por meqenëse unë nuk e bëj dot të njëjtën gjë, Elisa nuk e bën dot të përdorë të njëjtin fjalor ndaj jush, apo kushdo tjetër nga ne nuk e bën dot, nuk do të thotë që të krijoni epërsi dhe të mendoni se do të merrni vota me këtë lloj gjuhe.

A nuk e kuptoni që ka shumë kohë, në fakt, që qytetarët e këtij vendi pikërisht nga kjo duan të shpëtojnë, pikërisht këtë neveritin, këtë lloj politike? Kjo ka vetëm një të mirë për ju, që duke u lodhur shqiptarët ka rrezik t'iu dukemi të gjithë njëllor. E mund të humbasim edhe ne, por ju nuk mund të fitoni. Ju ku hyni këtu? Ju si fitoni në këtë bata? Duke mos na dalluar njërin nga tjetri, a e dini se kush fiton? Fiton sharlatanizmi. A doni të ikim të gjithë dhe të vijë sharlatanizmi në pushtet në Shqipëri?! Apo doni të vijë ata që deri sot nuk janë dëgjuar përkrahës të Rusisë, të Iranit dhe të fuqive, të cilat ne nuk i kemi pasur mes nesh dhe është turp i madh që për herë të parë Shqipëria, për shkakun tuaj, në rastin më të mirë të pakujdesisë, duke qenë shumë eufemik, ashtu siç dyshohet dhe dyshoj edhe unë me shumë të drejtë, për shkak të padurimit për të ardhur në pushtet ju keni shtrirë dorën në tokën e ndaluar të shqiptarëve dhe në atë që neve na jepte deri dje kredon dhe syrin e hapur që t'u thoshim të gjithëve se Shqipëria është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që nuk ka dilema gjeopolitike. Në Shqipëri çdo parti e majtë, e djathtë, e vogël, e madhe të gjitha janë të orientuara drejt Perëndimit. Na e hoqët këtë avantazh me historitë tuaja të rublave, na e hoqët këtë avantazh me historitë tuaja të bazimit të politikës në fshehjen e Putinit si thelbi i të gjitha të këqijave edhe i çmimit të energjisë, edhe i inflacionit të luftës. Ka një emër kriza, Vladimir Putin, ka një emër inflacioni, inflacioni i luftës. Këtë doni të fshihni ju? Këtë e di e gjithë Europa. Po për çfarë e bëni ju? E bëni për të fituar vota? Nuk fitohen vota duke u munduar si prestigjiatorë të bindni shqiptarët për një gjë që e shikojnë të gjithë ditën në televizor dhe në portale. Këto janë

shqetësime dhe probleme që po i vuan e gjithë Europa. Sot dha dorëheqjen Kryeministrja e Britanisë së Madhe. Pikërisht për shkak të këtyre problemeve të krizës dhe të çmimeve, të inflacionit dhe çmimeve të energjisë, të cilat rëndojnë mbi qytetarët dhe për të cilat mbase duke u përdorur, në fakt, nuk dua të flas tani dhe të jap opinionin tim pse po ikën Kryeministrja e Britanisë, por kjo tregon se kur luan me krizën energjetike, nuk ka të fituar dhe nuk mund të jesh jetëgjatë. Kështu që bashkohuni! Minimumi kurseni energjinë elektrike! Ky është minimumi që mund të bëni, ose bëni apel bashkë me ne për të kursyer energjinë dhe për të qenë më të kujdesshëm për të kaluar këtë dimër, i cili nuk pritet të jetë i lehtë, por nga i cili nuk pikon asnjë votë, të paktën për ju. Faleminderit!